



TOP ACRYLIC PAINT



PAKETIMI

3L / 9L / 15L



KOHA E THARJES

3-4 Orë



KONSUMI

4-5 m²/l

PËRSHKRIMI

TOP ACRYLIC PAINT është një bojë e bardhë e përgatitur nga një emulsion i tipit "polimer në ujë" e destinuar për lyerjen e fasadave të jashtme, që përveç rezinave akrilike dhe ujit përmban në përqindje të caktuara mbushës, pigmente e shtesa të tjera sikurse janë dioksid titani, talk, karbonat kalciumi, heksametafosfat natriumi, hidroksietilcelulozë, izotiazolinon, poliksiloksane, poliakrilat amoni, hidroksid kaliumi, të cilët përmirësojnë vetitë e bojës. Referuar përbërësve të saj, boja thahet 3 - 4 orë pas aplikimit, duke formuar një mbulesë të rrafshët fleksibël, e cila ka rezistencë të mirë ndaj fërkimit dhe qëndrueshmëri të mirë ndaj kushteve klimaterike.

FUSHA E PËRDORIMIT

TOP ACRYLIC PAINT është e përdorshme në mjedise të brendshme (mure, tavane, për bojatisjen e sipërfaqeve të suvatuara ose sipërfaqeve prej betoni.

NGJYRA: E bardhë.

PARAPËRGATITJA

Sipërfaqja që do të bojatiset, duhet të pastrohet nga pluhurat, yndyrnat apo nga shtresa të mëparshme të bojës, të lidhura dobët me sipërfaqet (shtresat e fryra). Rekomandohet paraprakisht lyerja me astar AN – 501 me bazë uji ose me astar NEODUR me bazë WHITE SPIRIT.

PËRDORIMI

Përgatitet boja duke i shtuar ujë deri në konsistencën e kërkuar. Për të realizuar një lyerje të mirë, duhet të aplikohen dy duar TOP ACRYLIC PAINT. Doza e pigmentit që mund të përdoret, është sipas rekomandimit të prodhuesit. Për dorën e parë hollimi i bojës me ujë duhet të jetë në masën 15 - 20%. Ndërsa për dorën e dytë në masën 10%. Lyerja aplikohet lehtësisht me rrul ose furçë.

NGJYRIMI

TOP ACRYLIC PAINT është e përshtatshme për të krijuar një gamë të gjërë bojrash me ngjyrë, duke përdorur 9 bazat ngjyuese NEON UNO COLOR PAINT dhe 9 bazat ngjyuese NEON RS COLOR PAINT, si dhe ngjyrimin nëpërmjet dozimit sipas sistemeve kompjuterike me 16 ngjyra.

KUJDES

Nuk lejohet aplikimi i bojës në sipërfaqe të njoma dhe në kushte të larta lagështie të mjedisit. Nuk rekomandohet përdorimi i bojës në temperaturë më të vogël se 50C. Pas përfundimit të lyerjes pajisjet duhet të lahen menjëherë me ujë dhe sapun.



TECHNICAL DATA (IN +23°C AND 50% U.R.)

Aparenca	Emulsion ujqor i bardhë
Densiteti (ISO2811, DIN 53217, ASTM D 1475)	1.58-1.62 g/cm ³
Vizkoziteti (RVDV -2T,R7)	3900-6500 cp
Mbetja e thatë (Termostat, 105°C/2orë)	≤ 67 %
Forca ndërmolekulare (RVDV -2T,R7)	88000-125000 newton/m ²
Vizkoziteti kinematik (RVDV -2T,R7)	2600-4200 mm ² /s
pH	≥8
Imtësia e grimcës (Elcometer 2050, ISO 1524; ASTM D 1210)	10-40 μm